

VENDIM
Nr. 12, datë 25.2.2015

PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTET NË VAZHDIM PËR
ARSIMIN, PJESË E FONDIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE PËR VITIN 2015

(Ndryshuar me vendimin nr. 44, datë 27.11.2015)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15 e të aneksit 3, të ligjit nr. 160, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Shpërndarjen e fondeve për projekte në vazhdim, me cikël financimi 2014-2015, për nënprogramin e arsimit (arsimi bazë, arsimi i mesëm i përgjithshëm), në vlerën 978 393 443 (nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e treqind e nëntëdhjetë e tre mijë e katërqind e dyzet e tre) lekë, pjesë e Fondit për Zhvillimin e Rajoneve për vitin 2015, specifikuar sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Projektet, sipas pikës 1, me vendndodhje territorin e komunave, të cilat nuk kanë përfunduar punimet brenda qershorit 2015, në përputhje me vendimin nr. 6, datë 9.2.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, do të financohen përmes një marrëveshje delegimi, partneriteti rajonal dhe/ose partneriteti ndërkomunar me:

a) bashkinë qendër, e cila do të “përthithë”, si njësi në ndarjen e re territoriale, komunën aplikuese, sipas ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”; dhe

b) këshillin e qarkut përkatës;

ku këto të fundit, si aplikant dhe autoritet kontraktues, do të zbatojnë projektin në emër dhe për llogari të komunës në territorin e të cilës shtrihet projekti.

3. Ngarkohen ministri i Arsimit dhe Sportit, ministri i Financave dhe Sekretariati i Përgjithshëm i Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, në Kryeministri, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi, pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Edi Rama

Zëvendëskryeministri	Anëtar;
Ministri i Financave	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Urban	Anëtar;
Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës	Anëtar;
Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	Anëtar;
Ministri i Arsimit dhe Sportit	Anëtar;
Ministri i Shëndetësisë	Anëtar;
Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Anëtar;
Ministri i Kulturës	Anëtar;
Ministri i Mjedisit	Anëtar;
Ministri i Punëve të Brendshme	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Çështjet Vendore	Anëtar;
Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Komunave të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	Anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	Anëtar.

Tabela 1. Projektet në vazhdim, në nënprogramin e arsimit, me cikël financimi 2014-2015

Nr.	Autoriteti Kontraktues	Emërtimi i projektit	Vlera e Kontratës (në Lekë)	Realizimi 2014	Vlera e Financimit për vitin 2015 (Lekë)
Qarku Berat					
1	Bashkia Berat	Projekti "Shkolla, qendër komunitare": Ndërtimi 3 fushave sportive polifunksionale në ambientet e shkollave, me lote (shkolla "Ajet Xhindoli", lagjja Muzakaj prej 2,796,300L; shkolla "28 Nëntori", prej 2,976,300L; shkolla "Xhemal Cekini" prej 3,653,076L)	7,424,000	4,684,440	2,739,560
2	Bashkia Berat	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Thimi Tani" Bashkia Berat	24,334,872	11,420,976	12,913,896
3	Komuna Gjerbes	Rikonstruksion pjesor shkolla 9-vjeçare fshati Zaloshnjë, Komuna Gjerbes, Skrapar	5,406,377	5,100,026	306,351
4	Bashkia Berat	Rikonstruksion i shkollës së mesme "Kristaq Capo" bashkia Berat	26,225,240	11,996,160	14,259,080
Qarku Dibër					
5	Komuna Gjoricë	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare dhe palestër Gjoricë, Komuna Gjoricë	38,962,110	14,475,170	24,486,940
6	Komuna Xibër	Shkolla e bashkuar Xibër, Komuna Xibër	55,193,734	36,005,940	19,667,915
7	Bashkia Peshkopi	Projekti "Shkolla, qendër komunitare": Ndërtimi i 4 terreneve sportive në shkolla të qytetit Peshkopi (shkolla "Nazmi Rushti; shkolla "Demir Gashi"; shkolla "Seit Najdeni"; shkolla "Selim Alliu")	31,174,406	-	31,174,406
8	Komuna Kala e Dodës	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare dhe ndërtim paleshër Radomire, Komuna Kala e Dodës	38,042,570	32,971,639	5,070,931
Qarku Durrës					
9	Bashkia Krujë	Rikonstruksion dhe shtesë anësore në shkollën 9-vjeçare nr. 4, Krujë, bashkia Krujë	55,689,274	29,673,048	26,016,226
10	Komuna Nikel	Rikonstruksion i shkollës së mesme "Ramazan Karaj", Nikel, komuna Nikel	27,952,323	14,800,641	13,139,530
11	Bashkia Fushë-Kruje	Ndërtim i shkollës së mesme "Shote Galica" Fushë-Krujë	163,231,283	81,901,475	81,329,808
Qarku Elbasan					
12	Bashkia Belsh	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Halit Uruci" Belsh, bashkia Belsh	59,762,348	35,857,408	23,904,940

13	Komuna Stëblevë	Ndërtim shkollë 1-katëshe, shkolla Fushë-Studenti, komuna Stëblevë, Librazhd	16,668,000	8,450,744	8,217,256
14	Bashkia Elbasan	Projekti "Shkolla, qendër komunitare": Ndërtimi i 4 mjediseve sportive në shkolla të qytetit Elbasan (shkolla "Naim Frashëri" prej 8,352,548L; shkolla "Sul Harri" prej 8,143,603L; shkolla "Abdyl Paralloi" 8,233,578L; shkolla "Adem Krasniqi" prej 9,772,643L)	32,376,545	22,348,542	10,028,003
15	Komuna Rrajcë	Ndërtim shkolla CU Urake, komuna Rrajcë	5,803,069	4,020,493	1,782,576
16	Bashkia Elbasan	Përfundim i punimeve në shkollën "Xhafer Hakani", Elbasan	11,987,760	6,000,000	5,987,760
17	Komuna Kukur	Rikonstruksion shkolla e bashkuar "Muharrem Zela", komuna Kukur	20,934,861	10,410,048	10,524,813
Qarku Fier					
18	Komuna Portëz	Ndërtim kopshti, komuna Portëz	7,706,580	3,132,192	4,574,388
19	Bashkia Fier	Projekti "Shkolla, qendër komunitare": Ndërtimi i 4 mjediseve sportive në shkolla të qytetit Fier, me lote (Shkolla "Jani Bakalli" prej 4,477,452L; Shkolla "Liri Gero" prej 5,323,962L; shkolla "Kristaq Gero" prej 5,323,962L; shkolla "Pinellopi Pirro" prej 5,323,962L)	13,497,107	13,260,640	205,037
20	Bashkia Fier	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Andon Xoxa" Fier	33,315,328	17,313,228	16,002,100
21	Bashkia Fier	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Jani Bakalli" Fier	22,107,000	11,052,380	11,054,620
22	Bashkia Patos	Rikonstruksion i shkollës së mesme "Zhani Ciko", Patos	42,966,761	15,735,233	27,231,528
23	Bashkia Divjakë	Rikonstruksioni i shkollës së mesme "Miti Zaka", Bashkia Divjakë	17,657,328	6,019,560	11,637,768
Qarku Gjirokastrë					
24	Bashkia Gjirokastrë	Terrene sportive në 4 shkolla (shkolla "Pandeli Sotiri"; shkolla "Thoma Papapano"; shkolla "Çajupi"; shkolla "Siri Shaplllo", lagje Granicë)	32,340,647	12,731,040	19,609,607
25	Bashkia Gjirokastrë	Rikonstruksion i shkollës së mesme "Siri Shaplllo", bashkia Gjirokastrë	33,045,881	18,163,567	14,882,314
Qarku Korçë					
26	Bashkia Korçë	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare "Mësonjëtorja e parë"	53,644,475	49,992,268	3,652,207
27	Bashkia Korçë	Terrene sportive në 4 shkolla të qytetit Korçë (shkolla "Demokracia"; shkolla "Naum Veqilharxhi"; shkolla "Sotir Gurra"; kompleksi shkollor rruga "Ajet Xhindoli")	35,414,886	34,999,999	415,000

28	Komuna Libonik	Ndërtim i shkollës cikli i ulët, fshati Poceste, komuna Libonik	13,796,377	7,617,097	6,179,280
29	Komuna Voskop	Rikonstruksion i shkollës së mesme Voskop sistem ngrohje, komuna Voskop	35,880,360	17,340,630	18,539,730
Qarku Kukës					
30	Komuna Arren	Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare, Arren	24,064,036	12,090,467	11,973,569
31	Bashkia Kukës	Ndërtim i shtesës së shkollës 9-vjeçare "Bajram Curri", Kukës	113,007,475	53,021,536	59,985,939
32	Bashkia Kukës	Projekti "Shkolla, qendër komunitare": Mjedise sportive në 4 shkolla 9-vjeçare (Ndërtim palestre sportive e shkollës "Lidhja e Prizrenit" prej 10093120L; Shkolla " Bajram Curri" & Shkolla " Riza Spahiu" prej 8851437 L; Shkolla " Ahmet Voka",Gostil, prej 3647120L)	22,591,677	14,494,654	8,097,023
Qarku Lezhë					
33	Bashkia Lezhë	Ndërtim kopshti në qytetin e Lezhës, bashkia Lezhë	28,359,932	6,839,983	21,519,949
34	Komuna Kaçinar	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Kaçinar, Mirditë	15,259,923	8,000,000	7,259,923
35	Bashkia Lezhë	Ndërtimi i qendrës sportive tip, tek kompleksi i shkollave (2 qendra)	20,518,380	13,336,947	7,181,433
36	Komuna Blinisht	Rikonstruksioni i shkollës "Pjetër Zahrishi", Komuna Blinisht, Lezhë	21,300,000	10,736,424	10,563,576
Qarku Shkodër					
37	Komuna Bërdicë	Rikonstruksion i shkollës 9- vjeçare "Bërdicë e Madhe", Komuna Bërdicë	19,914,678	9,993,900	9,920,778
38	Bashkia Shkodër	Projekti "Shkolla, qendër komunitare": Mjedise sportive në 4 shkolla (shkolla "Dëshmoret e Prishtinës" prej 2,442,622L; Shkolla "Ndoc Mazi" prej 8,751,168L; shkolla "Ismail Qemali" prej 8.751.168L; shkolla "Branko Kadia" prej 9,751,168L)	21,741,873	16,688,698	5,048,271
39	Komuna Shale	Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare fshati Gimaj, Komuna Shale	30,431,227	7,111,524	23,319,703
40	Komuna Fierzë	Ndërtim i shkollës 9-vjeçare, fshati Mezi, Pukë	28,626,278	14,513,391	14,112,887
41	Komuna Gruemirë	Rikonstruksion shkolla e mesme e bashkuar Gruemirë, komuna Gruemirë	22,195,654	10,601,502	11,594,152
Qarku Tiranë					

42	Bashkia Tiranë	Projekti "Shkolla, qendër komunitare": Terrene sportive në 4 shkolla 9-vjeçare të qytetit Tiranë (shkolla "7 Marsi" prej 6,800,987L; shkolla "Shkolla e Kuqe" prej 3,515,111L; shkolla "Servete Maçi" prej 3,515,111L; shkolla "Skënder Luarasi" prej 3,515,111)	17,346,320	-	17,346,320
43	Bashkia Tiranë	Rikonstruksion i plotë dhe shtesë ambientesh në shkollën e mesme "Qemal Stafa", njësia 10	152,297,454	-	152,297,454
44	Bashkia Kavajë	Ndërtimi i kopshtit në lagjen nr. 4 tek rruga "Sufajve" komuniteti i romëve Kavajë	20,609,694	14,179,499	6,430,195
45	Komuna Dajt	Shtesë kati i shkollës 9-vjeçare Qesarakë, Komuna Dajt	46,699,592	23,349,741	23,349,851
46	Komuna Vaqarr	Rikonstruksion , shtesë anësore 2 kate dhe palestër për shkollën e mesme të përgjithshme, Komuna Vaqarr	26,000,000	7,587,961	18,412,039
47	Komuna Ndroq	Rikonstruksioni i shkollës së mesme "Sadi Nuri", komuna Ndroq	23,643,197	12,219,375	11,423,822
Qarku Vlorë					
48	Komuna Novoselë	Ndërtim shkolla 9-vjeçare "Pilo Prifti", fshati Novoselë, komuna Novoselë	47,497,121	28,498,254	18,998,867
49	Bashkia Vlorë	Rikonstruksion kopshti nr. 10, Vlorë, bashkia Vlorë	12,455,832	10,200,165	2,255,667
50	Bashkia Vlorë	Projekti "Shkolla, qendër komunitare": Terrene sportive për 4 shkolla 9-vjeçare (shkolla "Teli Ndini"; shkolla "4 Heronjte"; shkolla "Marigo Posio"; shkolla Ibrahim Kushta"; shkolla "Zigur Lelo"; shkolla " Rilindja")	18,892,200	17,100,000	1,792,200
51	Bashkia Sarandë	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare, Gjashtë Sarandë	38,242,451	-	38,242,451
52	Bashkia Sarandë	Ndërtimi i kopshtit në zonën e sipërme urbane, Sarandë	38,652,422	-	38,652,422
53	Komuna Vranisht	Rikonstruksion shkolla e bashkuar Hore Vranisht, komuna Vranisht	45,618,775	23,035,616	22,583,159
54	Bashkia Vlorë	Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Zigur Lelo" Vlore, bashkia Vlorë	21,528,570	20,748,570	780,000
55	Komuna Brataj	Shkolla e mesme e bashkuar "Hamdi Rrap Lazaj" Gjorm, komuna Brataj	19,618,223	9,900,000	9,718,223
		Totali	1,859,654,486	881,722,791	978,393,443

(Ndryshuar tabela nr. 1 sipas tabelës së mëposhtëme me vendimin nr. 44, datë 27.11.2015)

Tabela 3. Ndryshim në vendimin nr. 12, datë 25.2.2015, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve

Projektit nr. 43, në tabelën 1 të këtij vendimi i reduktohet vlera e financimit për vitin 2015, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e kontratës (Lekë)	Vlera e financimit të miratuar për vitin 2015 (në lekë)	Fonde që i reduktohen financimit të vitit 2015 (Lekë)
		QARKU TIRANE			
43	Bashkia Tirane	Rikonstrukcion i plote dhe shtese ambjentesh në shkollën "Qemal Stafa", njësia 10	152,297,454	152,297,454	80,000,000

Tabelës 1 të këtij vendimi i ndryshon vlera totale e financimit për vitin 2015, si më poshtë vijon:

Nr.	Autoriteti kontraktues	Emri i projektit	Vlera e kontratës (Lekë)	Realizimi 2014 (në Lekë)	Vlera e financimit për vitin 2015 (në lekë)
		TOTALI	1,859,654,486	881,722,791	893,393,443